

## **Për zhvillimin e testimit për vlerësues dëmsh në sigurime**

Në zbatim të nenit 227 pika 1/dh të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe nenit 7, të Rregullores nr.35, datë 27.03.2019, “Mbi organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në AMF”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, njofton të gjithë të interesuarit, se:

Më datën **20 shtator 2022**, do të zhvillohet testimi për rinovim të licencës së vlerësuesit të dëmeve në sigurime dhe më datë **27 shtator 2022**, do të zhvillohet testimi për pajisje me licencë të personave fizikë që aplikojnë për licencë si vlerësues dëmsh në sigurime.

Në testim do të marrin pjesë të gjithë ata aplikantë (për rinovim apo licencë të re) që plotësojnë të gjitha kërkesat e Ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 dhe Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017, “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar.

Përsa më sipër, të interesuarit të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar duke e depozituar në Autoritet deri më datë 15 gusht 2022.

Për detaje lidhur me zhvillimin e testeve aplikantët që plotësojnë kërkesat ligjore do të njoftohen paraprakisht.

Për më tepër informacion kontaktoni [amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al).